

ADMINISTRATA TATIMORE e KOSOVËS (ATK)- Divizioni i Ankesave në përbërje të panelit shqyrtues: znj. Ylibere Fazliu kryesuese, znj. Ermine Nikqi dhe z. Bashkim Paçarizi anëtar, duke vendosur në çështjen administrative tatimore sipas ankesës së subjektit tatimor [redacted] ankesa me nr. [redacted] protokollit 441/2022 e dorëzuar në Divizionin e Ankesave - ATK më datë 12.10.2022, në mbështetje të nenit 77 të Ligjit Nr. 03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, kundër Njoftim Rivlerësimeve të lëshuara nga Drejtoria Rajonale e ATK-së Prishtina I, në seancën dëgjimore të mbajtur me dt. 25.10.2022 në prezencë të palëve : z. Xhafer Asani pronar, i autorizuar z. Hakif Veliu, inspektori tatimor z. Pajtim Grainca, nga zyra Ligjore z. Artan Krasniqi, zyra e avokatit të tatimpaguesve edhe pse të ftuar nuk ishin pjesëmarrës, mori këtë:

### VENDIM

- I. Apropohet pjesërisht Ankesa nr. 441/2022 dt. 12.10.2022 e tatimpaguesit "[redacted]" në mbështetje të nenit 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 "Për Procedurën Administrative" në lidhje me paragrafin 2 të nenit 89 të Ligjit Nr. 03/L-222 "Për Administratën Tatimore dhe Procedurat".
- II. Korrigohej Njoftim Rivlerësimet e tatimit shtesë për periudhat tatimore CD 2018 nga obligimi 4.126,25€ në 3834,41€, periudhat e TVSH-së 01/2018-12/2018 nga obligimi 6856,06€ në 2.952,70€, CD 2019 nga (-13.017,20€) në (-31.806,65€), periudhat e TVSH-së 01/2019-12/2019 nga obligimi 8,030.11€ në 1,192.97€, CD 2020 nga obligimi 1,161.14€ në (-2,006,40€), periudhat e TVSH-së 08,09,11,12/2020 nga obligimi 3,391.95€ në 1,021,79€ vlerësimet tjera mbesin obligim pagese.
- III. Procedura e ankesës nuk ndërprehet obligimin e tatimpaguesit për pagesë të detyrimeve tatimore (tatim, ndëshkime dhe interes) në përputhje me nenin 9, paragrafin 1 të Ligjit Nr. 04/L-102 për Ndryshim Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

### Arçyetim

Tatimpaguesi më datë 23.09.2022 ka pranuar Njoftim Rivlerësimet të lëshuara nga Drejtoria Rajonale e ATK-së- Prishtina I dhe brenda afatit të përcaktuar ligjor ka parashtruar ankesë në Administratën Tatimore të Kosovës-Divizionin e Ankesave me dt. 12.10.2022 në përputhje me nenin 77, paragrafin 2, të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, si dhe nenin 44, paragrafin 7, të Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2010 për Zbatim të Ligjit Nr. 03/L-222 "Mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat".

Veprimtaria e subjektit tatimor është tregtia me shumicë dhe pakicë e produkteve për nxehtë. Ankesë në raportin e kontrolli të ATK-së datë 22.09.2022, sa i përket deponimeve në bankë 2018, 2019 dhe 2020 konstatimi i inspektorit të ATK-se, është i gabuar dhe jo i drejtë dhe është në kundërshtim të plotë dispozitat ligjore të nenit 30, paragrafi 30.2 të UA 15/2010 (MDBShK), sepse nuk janë marrë parasysh të gjitha dokumentet e ofruara nga tatimpaguesi me rastin e kontrolli të. Për faktin se, deponimet e bëra në xhirologari kanë qenë të hyra në bazë të faturave të lëshuara, të cilat fatura janë pranuar në kesh, të regjistruara në arkë dhe

pastaj janë deponuar në bankë, ku për secilin faturë të lëshuar ofrojmë dëshmi të argumentuara se, të gjitha pa përjashtim kanë qenë të deklaruar dhe të raportuar në ATK, në momentin e ndodhjes, sipas parimit akrual. Për me tepër këto deponime i trajton si të hyra pa TVSH duke i ngarkuar edhe me normën 18%, duke na e renduar edhe me shume dhe pa drejtësisht me qarkullim shtesë prej 8,872.88€. Për vitin 2018 lidhur me faturat e lëshuara dhe të deponuara në bankë janë: Fatura nr.221/18, e datës 05.09.2018, totali: 3,204.43€ (4 është për shkak se bankinat nuk ka pranuar monedha të imta).Fatura nr.223/18, e datës 07.09.2018, totali: 5,50.00€ (janë deponuar ndarazi shuma 1,350.00 dhe 3, 700.00, por totali i tyre lidhet me faturën dhe shumën e faturës, deponimet janë bera ne bankinat dhe ne raste te ndryshme nuk i ka pranuar te gjitha për një herë por ne raste te ndara).Fatura nr.263/18, e datës 18.10.2018, totali: 910.00€.Fatura nr.266/18, e datës 18.10.2018, totali: 820.00€ dhe Fatura nr. 275/18, e datës 20.10.2018, totali: 490.00€. Për vitin 2019 sipas qarkullimit shtesë prej 32,203.39€ ndërliiden me faturat e lëshuara dhe të deponuara në bankë janë: Fatura nr.76/19; 77/19 dhe 78/19, e datës 17.09.2019, në total 9,670.00€;Fatura nr.79/19, e datës 18.09.2019, në total 3,579.50 (por të deponuara në bankë në shume prej 3,390,00€, deponimet janë bërë ne bankinat; Fatura nr.84/19 dhe 86/19, e datës 25.09.2019, në total 6,120.00€ .Fatura nr.87/19, e datës 27.09.2019, në total 2,050.00€;Fatura nr.101/19, e datës 09.10.2019, në total 5,150,00€, Fatura nr.104/19, e datës 12.10.2019, në total 4,120.00€; Fatura nr.109/19, e datës 21.10.2019, në total 7,500.00€. Për vitin 2020 sipas inspektorit deponimet bankare të pa arsyetuara në vlerën pa TVSH 11,940.68€, të cilat konsiderohen si qarkullim shtesë, fatuqat e lëshuara dhe të deponuara në bankë janë: Fatura nr. 54/20, e datës 18.08.2020, në total 8,150.00€, (e deponuar në bankinat në shumën 4,800.00€ dhe pjesa tjetër e mbetur në arkë);Fatura nr.55/20, e datës 20.08.2020, në total 1,550.00€,Fatura nr.56/20, e datës 22.08.2020, në total 1,315.00€;Fatura nr.63/20, e datës 14.09.2020, në total 3,520.00€;Fatura nr.65/20, e datës 15.09.2020, në total 1,715.00€; Fatura nr.73/20 dhe 74/20, e datës 25.09.2020, në total (496.00+464.00=960.000;Fatura nr.106/20, e datës 16.11.2020, në total 205.000 (e deponuar në bankinat 200.00€).Cilësimi i marzhës nuk është aplikuar drejtë ne pajtim me dispozitat ligjore të nenit 30.3, të UA 5/2015, të MM, sepse ne rastet të tilla të aplikimit të marzhës dhe rritjes së sajë, duhet të merren shumë faktorë siç edhe parashihen me dispozita të deklaruar në deklaratat tatimore. Mogjithatë, është e preferueshme të përdoren marzhat e vërteta të tatimpaguesit nëse është e mundur. Aplikimi i gabuar dhe jo i drejte të nenit 36, paragrafi 5.2 të TVSH-së, te gjendjes faktike të shpenzimeve të karburanteve, sepse dispozitat e këtij ligji kanë paraparë edhe rastet nëse, nuk është mbajtur evidencë e shpenzimeve të derivateve sa i përket normativit të derivateve dhe kilometrave të kaluara, ku ne mbështetje të këtij neni pranohen 50% e shpenzimeve të derivateve, për me tepër kjo është edhe praktike e deritanishme e aplikuar nga Administrata Tatimore e Kosovës, e jo komplet të gjitha shpenzimet e derivateve të mos pranohen, sepse biznesi ka në pronësi aset pune mo te cilat operon dhe pa të cilat nuk mund të funksionoj, janë të regjistruara në librin e aseteve dhe janë në pronësi të kompanisë (provë lista e aseteve në arsyetim). Dhe, për me tepër Inspektori tatimor e pranon zhvlerësimin e aseteve, sepse janë në pronësi të biznesit dhe nuk e pranon as një shpenzim të derivateve, ku të gjitha faturat e shpenzimeve të derivateve janë të rregullta, transaksione te realizuara në mes të dy bizneseve të tatueshme dhe të paguara në kohe dhe brenda afateve ligjore. Pretendojmë se lëshimi i gjobave nga Zyra e Gjobave dhe ndëshkimeve (ZGJONA), ku departamenti në fjalë, lëshon gjobe për secilin vit në shume prej 3,500.00€ pa drejtësisht.

Vlerësimi i kontrollit: Biznesi është i regjistruar 01.07.2008. Kontrolli është iniciuar nga analiza e riskut, kontrolli ka filluar 25.02.2022 duke përfshi periudhat 01/2018-01/2022 TVSH 2018-2020 CD .Tatimpaguesi kontrole paraprake ka pasur. Me procedurë kontrolli janë analizuar blerjet e tatimpaguesit dhe nuk ka pasur ndryshime .Me procedurë kontrolli gjatë verifikimit të llogarive bankare ka pasur deponime të pa arsyetuara, për vitin 2018 në vlerë të tatueshme 8,872.88€,për vitin 2019 32,203.39€, për vitin 2020 11,940.68€ të cilat vlera janë vlerësuar qarkullim shtesë. Tatimpaguesi posedon shitje ndaj personave juridik dhe

shitje ndaj personave fizik, duke shprehur në përqindje për shitjet e personave fizik për periudhën 2018 ka aplikuar marzhë prej 12,81% dhe duke e aplikuar vlerën e hapur të tregut është marrë marzha mesatare aplikuar në disa biznese tjera të lëmosë së njëjtë prej 20,12% dhe diferenca e marzhë prej 7,31% është marrë për bazë, qarkullimi i konstatuar 274,167.70 x7,31% 20,041€.

Për këtë periudhë nuk janë pranua shpenzimet e derivateve në vlerë 9,175.25€ mungesë evidence. Për periudhën 2019 ka aplikuar marzhë prej 14,92% dhe duke e aplikuar vlerën e hapur të tregut është marrë marzha mesatare aplikuar në disa biznese tjera të lëmosë së njëjtë prej 20,08% dhe diferenca e marzhë prej 5,16% është marrë për bazë, qarkullimi i konstatuar 100,853.25€ x5,16% 5,204.50€.

Për këtë periudhë nuk janë pranua shpenzimet e derivateve në vlerë 7,204.00€ mungesë evidence. Për periudhën 2020 ka aplikuar marzhë prej 13,41% dhe duke e aplikuar vlerën e hapur të tregut është marrë marzha mesatare aplikuar në disa biznese tjera të lëmosë së njëjtë prej 23,42% dhe diferenca e marzhë prej 10,01% është marrë për bazë, qarkullimi i konstatuar 69,312.01€ x10,01% 6,903.50€.

Për periudhën 2021 ka aplikuar marzhë prej 13,46% dhe duke e aplikuar vlerën e hapur të tregut është marrë marzha mesatare aplikuar në disa biznese tjera të lëmosë së njëjtë prej 18,70% dhe diferenca e marzhë prej 5,24% është marrë për bazë qarkullimi i konstatuar 82,170.00€ x5,24% 4,305.00€.

Me dt.04.03.2022 është bërë verifikimi i stokut dhe ka rezultuar mungesë në vlerë blerëse prej 15,702.50€ dhe vlera shitëse prej 18,639.50€ trajtohet qarkullim shtesë në periudhën 01/2022. Vlerësimi për periudhat e kontrollit ka rezultuar dhe obligim në vlerë 34,102.36€ për periudhat 01/2018-01/2022 TVSH dhe CD 2020 279.00€ me ndëshkime.

Divizioni i Ankesave për shqyrtim më detal të ankesës ka mbajtur seancën dëgjimore me datë 25.10.2022 në bazë të nenit 95, të ligjit nr.05/L- 031 Për Procedurën Administrative, në prezencë të palëve procedurale. Me pëlqimin e palëve nuk u lexua ankesa me shkrim. Përfaqësuesi i tatimpaguesit në të drejtën e fjalës cek se kontestojmë deponimet të cilat janë trajtuar si shitje ,pasi që për ato deponime ne i kemi trajtuar si shitje me fatura të shitjes dhe të gjitha shitjet e pazarit ditor i deponojmë në bankë si Pazar ditor. Kontesti i dytë është metoda e marzhës ku ne si biznes e kemi aplikua marzhën drejtë, andaj kontrolli marzhën e ka trajtua me vlerën e hapur të tregut. Kontesti tjetër është mospranimi i shpenzimeve të derivateve kur nuk është pranua asnjë shpenzim ,ne s' kemi pasur evidence por kemi menduar që të paktën të pranohet 50% të shpenzimeve. Pronari i biznesit thekson se ka mundësi që dokumentet të mos jenë të kompletuara pasi që në kërkesën e kontrollit kam qenë në Slloveni për çështje shëndetësore andaj ka pasur mundësim të ndodh ndonjë gabim teknik.

Inspektori në mbështetje të vlerësimit, në të drejtën e fjalës theksoi se kontrolli është hapur nga analiza e riskut ,andaj për çështje të deponimeve punëtori e ka sjellë ditarin e arkës dhe shumica e deponimeve kanë qenë në përputhshmëri me ditarin e arkës dhe dëshmitë që i ka sjellë për deponimet e kontestua ra me kontroll kanë qenë me vonesë. Tek shpenzimet e naftës nuk janë pranuar këto shpenzime por edhe shpenzimet e zhvlerësimit pasi që tatimpaguesi nuk ka ofruar dokumente të mjaftueshme .Kurse sa i përket marzhës unë e kam bërë analizën e shitjeve me pakicë dhe kam marrë informatën nga bizneset për të bërë krahasimet dhe marzha është marrë si e përgjithshme. Me regjistrim të mallit ka pasur diferenca ku pastaj kemi aplikua marzhën për mungesat e stokut momental.

Divizioni i Ankesave me datë 17.11.2022 sipas Nenit 77 paragrafi 7 i Ligjit nr.03/L-222" Mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat " dhe të Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2010 neni 44 të paragrafit 18 u kërkuan sqarime shtesë me Vendim nga Drejtoria Rajonale Prishtina I, që të mi shqyrtoj rastin dhe të hartoj një raport të ri dhe rasti u suspendua.

Tatimpaguesi u njoftua për kërkesën për rishqyrtim brenda 3 ditëve të punës pasi kemi dërguar vendimin zyrës regjionale përkatëse e cila ka përfshirë edhe këshillën se vendimi

final nga Divizioni i Ankesave do të lëshohet brenda 45 dite nga dita kur tatimpaguesi është njoftuar për rishikim.  
Drejtoria Rajonale Prishtina I ,ka dërguar raportin tek Divizioni i Ankesave sipas kërkesave të përcaktuara .

Administrata Tatimore e Kosovës - Divizioni i Ankesave pas shqyrtimit të ankesës, seancës dëgjimore dhe pas administrimit ,vlerësimit të gjitha provave në shkresat e lëndës, raportit shtesë, paneli vlerësoi se ankesa e subjektit në procedurë është pjesërisht e bazuar.

Dispozitivi i këtij vendimi të Divizionit të Ankesave është i mbështetur në faktet në vijim:

- Divizioni i Ankesave pas analizimit të shkresave në lëndë, përkatësisht Raportit të Kontrollit, Fletave të Punës së Kontrollit, Njoftim Rivlerësimeve të Tatimit Shtesë, provave materiale të bashkangjitura ankesës , analizimit të pretendimeve ankimore të tatimpaguesit dhe gjatë ecurisë së shqyrtimit të ankesës ,në nivelin e mëpastajshëm të Divizionit të Ankesave tatimpaguesi ka prezantuar dokumentet materiale sa i përket pikës kontestuese në lidhje me deponimet në bankë 2018,2019 dhe 2020 ku potencohet se vlerësimi i kontrollit të ATK-se, është i gabuar dhe jo i drejte sepse nuk janë marrë parasysh të gjitha dokumentet e ofruara nga tatimpaguesi. Për faktin se, deponimet e bëra në xhirrollogari kanë qenë të hyra në bazë të faturave të lëshuara, të cilat fatura janë pranuar në kesh dhe pastaj janë deponuar në bankë, ku për secilën faturë të lëshuar ofrojmë dëshmi të argumentuara, se të gjitha pa përjashtim kanë qenë të deklaruara dhe të raportuara në ATK, në momentin e ndodhjes, sipas parimit aktual. Divizioni i Ankesave, mbi bazën e këtij kontesti ka analizuar përmbajtjen e këtyre provave materiale të sjella me Ankesën me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës , kryesisht ka analizuar faturat kontestuese me ankesë për të cilat konstaton se faturat për periudhën 2018,2019 dhe 2020, dëshmohen me kuponë fiskal për të cilët kanë bërë shitje ,vlerat të cilat janë deponuar në llogarinë bankare dhe faktikisht përputhen në librat të regjistruara dhe faktikisht përputhen edhe me deklaratimet për periudhat përkatëse, andaj mbi bazën e këtyre të dhënave me raport shtesë kemi kërkuar të trajtohen dhe të konfirmohen të njëjtat periudha në ri procedurë dhe të vlerësohet drejtë. Sipas Raportit shtesë dt.01.12.2022 për këtë pikë kontestuese nuk konsiderohet shkak i arsyeshem mos përfshirja e transaksioneve në Librin e Arkës, pasi për këtë pa rregullsi mundë të ndëshkohet sipas nenit 43 paragrafi 95 i UA 15/2010 dhe se faturat për periudhën 2018,2019 dhe 2020, dëshmohen me kuponë fiskal për të cilët kanë bërë shitje ,vlerat të cilat janë deponuar në llogarinë bankare dhe faktikisht përputhen në librat të regjistruara dhe gjithashtu faktikisht përputhen edhe me deklaratimet për periudhat përkatëse nga transaksionet që është përcaktuar detyrimi tatimor.

Sipas kontestit të tatimpaguesit aplikimi i marzhës nuk është aplikuar drejtë në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 30.3 të UA 5/2015 të MM, sepse në rastet të tilla të aplikimit të marzhës dhe rritjes së sajë, duhet të merren shumë faktorë siç edhe parashihen me dispozita të këtij neni, këto përqindje, merren nga analizat e zërave përkatës të deklaruar në deklaratat tatimore. Divizioni i Ankesave për këtë pikë kontestuese ka poseduar fletat e punës nga kontrolli me vetëm informatat se cilat subjekte janë analizuar dhe përqindjen e marzhës së nxjerrë nga këto subjekte për periudhat 2018-2021.andaj në mungesë të parametereve tjerë të analizuar, të plotësohet dhe të mbështetet Vlera e Hapur e Tregut si që e kërkon paragrafi 1.15 i nenit 1 i Ligjit Nr. 03/L-222 mbi " Administratën Tatimore dhe Procedurat" dhe paragrafi 1.12 i nenit 1 i Ligjit Nr. 05/L-029,mbi të gjitha të bëhen analizë çmimet e shitjes personave juridik-me fatura dhe çmimet e shitjes me pakicë-kuponë fiskal. Sipas Raportit shtesë dt.01.12.2022 aplikimi i marzhës është verifikuar dhe ka ndryshime për periudhën 2018 nga marzha e aplikuar me kontroll prej 20.01% në 17.12% ,për periudhën 2019 nga

marzha e aplikuar me kontroll prej 20.32% në 17.93%, për periudhën 2020 nga marzha e aplikuar me kontroll prej 23.49% në 21.60%, për periudhën 2021 nga marzha e aplikuar me kontroll prej 18.70% në 17.12%.

Pas pretendimit të tatimpaguesit se është aplikuar gabimisht dhe jo drejtë neni 36, paragrafi 5.2 të TVSH-së, të gjendjes faktike të shpenzimeve të karburanteve, sepse dispozitat e këtij ligji kanë paraparë edhe rastet nëse, nuk është mbajtur evidence e shpenzimeve të derivateve sa i përket normativit të derivateve dhe kilometrave të kaluara, ku ne mbështetje të këtij neni pranohen 50% e shpenzimeve të derivateve, për me tepër kjo është edhe praktike e deritanishme e aplikuar nga Administrata Tatimore e Kosovës, e jo komplet të gjitha shpenzimet e derivateve të mos pranohen. Divizioni i Ankesave, gjatë procedurës së shqyrtimit të lëndës për këtë kontest ka kërkuar nga tatimpaguesi mbajtjen e evidencës të shpenzimeve të derivateve dhe nga evidencia e ofruar nga tatimpaguesi konstatohet se tatimpaguesi përveç blerjeve me kuponë fiskal ka të mbështetur edhe faturat nga subjekte të ndryshme me përshkrimin dhe vlerën e shitjes së mallit të njëjtë si në kuponë fiskal. Duke u mbështetur në nenin 20 të Udhëzimit Administrativ 15/2010 pasi që faturat e blerjeve janë të lëshuar në bazë të kuponëve si që parashihet me legjislacionin tatimor përkatësisht me Udhëzimin Administrativ 15/2010 Neni 20 paragrafi 4 i cili parashihet: *Kuponi i regjistruarit të kesh-it. Secili person i angazhuar në shitje me pakicë duhet ta fusë atë transaksion në një regjistruar fiskal të kesh-it, apo pajisje tjetër të aplikueshme sikurse është përshkruar në këtë Udhëzimin Administrativ, që lidhet me regjistruarit fiskal të kesh-it apo pajisjet elektronike fiskale. Duke pasur parasysh kërkesat për të dokumentuar origjinën e mallrave, një person që kryen blerje në shitjen me pakicë duhet të posedojë një kupon të regjistruarit të kesh-it që do të ofrojë evidencë dokumentuese për origjinën e mallrave në posedim. Megjithatë, për një blerje me pakicë për të kërkuar si shpenzim në një Deklaratë të Tatimit në të Ardhurat e Korporatave (në vijim TAK) apo Deklaratë të Tatimit në të Ardhurat Personale (në vijim TAP), një kupon i regjistruarit të kesh-it duhet të shoqërohet me një faturë sikurse është përshkruar në paragrafin 1, 2 apo 3 të këtij Neni, varësisht nga statusi i shitësit dhe blerësit. Një kupon i lëshuar nga një regjistruar i kesh-it duhet të përmbajë së paku elementet vijuese (specifikacionet teknike pasuese për arkat fiskale dhe pajisjet elektronike fiskale mund të kërkojnë elemente tjera shtesë në një format të veçantë, në të cilin rast një kupon i regjistruarit të kesh-it duhet të plotësojë ato elemente shtesë për të shmangur ndëshkimet), Andaj të konfirmohen dhe të vlerësohen këto regjistrime të mbajtura a janë të mjaftueshme, të sakta, për të lu mundësua tatimpaguesit si shpenzime të aplikueshme.*

Gjithashtu duke u ndërlidhur me kontestin se biznesi ka në pronësi asete pune - automjeto me të cilat operon dhe pa të cilat nuk mund të funksionoj, janë të regjistruara në librin e aseteve dhe janë në pronësi të kompanisë (provë lista e aseteve në arsyetim). Dhe, për me tepër pranon zhvlerësimin e aseteve, sepse janë në pronësi të biznesit dhe nuk e pranon as një shpenzim të derivateve. Mbajtja e evidencës të shpenzimeve të derivateve nga evidencia e ofruar nga tatimpaguesi konstatohet se tatimpaguesi përveç blerjeve me kupon fiskal ka të mbështetur edhe me faturat nga subjekte të ndryshme me përshkrimin dhe vlerën e shitjes së mallit të njëjtë si në kupon fiskal. Andaj, mbështetur në neni 20 të Udhëzimit Administrativ 15/2010 pasi që faturat e blerjeve janë të lëshuar në bazë të kuponëve si që parashihet me legjislacionin tatimor përkatësisht me Udhëzimin Administrativ 15/2010 Neni 20 paragrafi 4 dhe neni 36, paragrafi 5.2 të TVSH-së pranohen 50% e shpenzimeve të derivateve.

Divizioni i Ankesave do të korrigjoj Njoftim Rivlerësimet sa i përket pikës kontestuese në lidhje me deponimet në bankë për periudhën 09,10 të vitit 2018 në vlerë pa TVSH 8,872.88€, për periudhën 09,10 të vitit 2019 në vlerë pa TVSH 32,203.39€, për periudhën 08,09,11 të vitit 2020 në vlerë pa TVSH 11,940.68€. Po ashtu do të korrigjoj periudhat: 2018, tatimpaguesi ka aplikuar marzhë prej 12,81% dhe duke e aplikuar vlerën e hapur të tregut nga e cila është verifikua me Raport shtesë marzha mesatare prej 17,12% dhe diferenca e marzhë prej 4,31% merret për bazë qarkullimi i konstatuar 274,167.70 x4,31% 11,816.27€. Për periudhën 2019 ka aplikuar marzhë prej 14,92% dhe duke e aplikuar vlerën e hapur të tregut nga është verifikua me Raport shtesë marzha mesatare prej 17,93% dhe

diferenca e marzhë prej 3.01% merret për bazë qarkullimi i konstatuar 100,853.25€ x 3.01% 3,025.59 €. Për periudhën 2020 ka aplikuar tatimpaguosi marzhë prej 13,41% dhe duke e aplikuar vlerën e hapur të tregut është verifikua me Raport shtesë marzha mesatare prej 21.60% dhe diferenca e marzhës prej 8.19% merret për bazë qarkullimi i konstatuar 69,312.01€ x 8.19% 5,676.65 €. Për periudhën 2021 ka aplikuar marzhë prej 13,46% dhe duke e aplikuar vlerën e hapur të tregut është verifikua me Raport shtesë marzha mesatare prej 17,12% dhe diferenca e marzhë prej 3.66% merret për bazë qarkullimi i konstatuar 82,170.00€ x 3.66% 3,007.42€. Gjithashtu do të korrigoj 50% për vitin 2018 shpenzimet e derivateve në vlerë 9,175.25€ për periudhat 01/2018-12/2018 dhe për vitin 2019 shpenzimet e derivateve në vlerë 7,204.00€ për periudhat 01/2019-12/2019 të përpunuar në sistemin e Teknologjisë Informativë – SIGTAS- pas Ankesave, ndërsa pjesa tjetër e vlerësimeve mbetet e pa ndryshuar dhe obligim pagese për tatimpaguesin.

Sipas pretendimit të tatimpaguesit, lëshimi i gjobave nga Zyra e Gjobave dhe ndëshkimeve (ZGJONA) për secilin vit të kontrollit, sipas Divizionit të Ankesave janë të mbështetura sipas nenit 43 paragrafi 98.3 të UA Nr.5/2010.

Andaj, për pa rregullsitë e konstatuara në vlerësim të kontrollit, ndëshkimet dhe interesi rrjedhin në bazë të Nenit 51.1 dhe 28.1 dhe të Nenit 52 të Ligjit Nr. 03/L-222 "Mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat".

Nga arsyet e theksuara më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi bazuar në nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 Për Procedurën Administrative.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi bazuar në nenin 3 të Ligjit Nr. 04/L-102 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-222, Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, tatimpaguosi i pa kënaqur ka të drejtën që brenda afatit tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të Vendimit të Divizionit të Ankesave, ta kundërshtojë këtë vendim në Divizionin Fiskal të Departamentit Administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

**DIVIZIONI I ANKESAVE NË PRISHTINË**  
Nr: 441/2022 datë 09.12.2022

Vendimi t'u dorëzohet :

1. Tatimpaguesit
2. Administratës Tatimore

Udhëheqës i Divizionit të Ankesave  
Skender Krasniqi \_\_\_\_\_

Kryesuese e panelit  
Ylbere Fazliu \_\_\_\_\_

